

IDETË TONA NË DEMOKRACI



QYTETARËT ME TË DREJTAT E PËRGJEGJËSITË

EMA (9), DEA (9), BENARDI (9), ELISONI (10), MIGJENI (9), AGNESA (9), YLLKA (9), ORGESI (9)



Ne si qytetarë i kemi të drejtat tona, por ne i respektojmë edhe përgjegjësitë tona

Në një vend demokratik, populli udhëheq në vendin e vet. Qytetar është secili person, i cili ka të drejtën e përkatësisë në një shtet të caktuar.

Demokraci do të thotë kur të gjithë qytetarët i kanë të drejtat e barabarta, por krahas këtyre të drejtave ne i kemi përgjegjësitë tona. Këto të drejta, ne i gëzojmë pa dallim feje, race, gjinie, kombësie, etj.

Ne si qytetarë kemi të drejtën për të jetuar, të drejtën për të shprehur mendimin tonë, si p.sh. kur e kemi një ide në klasë, mësuesja na lejon ta shprehim atë. Ne kemi të drejtë të kemi një shtëpi dhe të drejtën për të punuar. Kur ne të rritemi, Dea do të bëhet mjeke, Ema farmaciste, Benardi futbollist, Agnesa atlete, Yllka shkrimtare, Migjeni polic, Orgesi kuzhinier dhe Elisoni këngëtar.

Ne kemi të drejtën që kur të bëhemi 18 vjeç të votojmë, kemi të drejtën të krijojmë familje, të drejtën për t'u shkolluar, etj. Por, ne gjithashtu kemi edhe përgjegjësitë tona, e ato janë: të shkojmë në shkollë, ta mbajmë ambientin pastër, t'i respektojmë të tjerët, të mos i përqeshim të tjerët, t'i ndihmojmë personat me nevoja të veçanta. Po ashtu, duhet t'i paguajmë faturat me rregull, si faturën e rrymës, të ujit, etj. Ne në shkollën tonë i respektojmë mësuesit tanë, drejtorin dhe mysafirët që vijnë të na vizitojnë dhe kjo do të thotë se ne jemi qytetarë të mirë.



Të lumtur që jetojmë në demokraci



Duke punuar mozaikun me të drejtat dhe përgjegjësitë



Ne punojmë së bashku

VOTIMI YNË

ALTINA (9), EJONA (12), POEMA (9), ERMIRA (9), ARBËR (8), DURIM (9), THEODORA (9)

Ne sot do t'iu tregojmë në faqen tonë gjëra të reja për demokracinë, zgjedhjet dhe votimin. Ne jemi klasa IV-1 dhe grupi "Rrushi,."

Sot kemi mësuar për zgjedhjet në të cilat, ne nuk mund të marrim pjesë në procesin e zgjedhjeve, por kur t'i bëjmë 18 vjeç ne mund të votojmë për kryetarin e komunës dhe asamblenë komunale ose për deputetët e kuvendit. Por, në klasë apo në shtëpi ne jemi të lirë të votojmë.

Të gjithë ne mund të votojmë, nuk ka rëndësi çfarë race feje apo gjinie kemi. Në fillim, gratë nuk kanë pasur të drejtë të votojnë, por tashmë kanë të drejtë të votojnë edhe gratë edhe burrat.


Dhe gjithashtu, ne kuptuam se vota është e fshehtë. Ne kemi bashkëpunuar si grup, kemi mësuar për zgjedhjet dhe në fund kemi vizatuar për to.




Grupi "Rrushi,, i lumtur




Ne, grupi "Rrushi,, duke mbajtur shenjën "VOTO,,



Kutia e votimit e vizatuar nga Ermira




Demokracia e punuar nga Arbëri



Me anë të puzzle-it kemi paraqitur votimin

KUVENDI NË NJË SHTET DEMOKRATIK

ANES (10), MURSEL (9), ERIS (9), HANA (9), LEARTA (9), EDISON (9), ASRA (9)



Ne sot mësuam për demokracinë dhe për funksionimin e Kuvendit të Republikës së Kosovës

Kuvendi është Shtëpia e Popullit. Kuvendi ka detyra të ndryshme, si p.sh.: të propozoj ligjet, të miratoj ligjet, zgjedh dhe e mbikëqyr Qeverinë, zgjedh Presidentin dhe mund ta shkarkoj atë, zgjedh dhe mund të shkarkoj Qeverinë, etj. Një detyrë kryesore e Kuvendit të Kosovës është të përfaqësoj popullin e Kosovës. Kuvendi përveç detyrave, ka edhe tri funksione e ato janë



Gazetarët duke punuar për artikull

funkcioni ligjvënës sepse miraton ligjet, kontrollues sepse kontrollon qeverinë, dhe ka funksion përfaqësues sepse e përfaqëson popullin. Kuvendi është institucion shtetëror, i cili ka rol shumë të rëndësishëm në një shtet demokratik. Kosova është shtet demokratik dhe e ka Kuvendin e saj. Në Kuvendin e Republikës së Kosovës janë 120 deputetë. Prej këtyre 120 deputetëve, 100 prej tyre janë të komunitetit shumicë, dhe

Libri i Kuvendit

20 prej tyre janë të komuniteteve jo shumicë. Këta deputetë ia duan të mirën gjeneratave të reja, sepse këto gjenerata mundën të zbulojnë teknologji të reja dhe të zhvillojnë vendin tonë dhe t'ia lehtësojnë punën demokracisë. Ne jetojmë në një vend demokratik dhe të pavarur, siç është Republika e Kosovës. Ne si gjeneratë e re do të kujdesemi që Kosova do të jetë shtet sa më i zhvilluar.



Gazetarët e këtij artikulli

DEMOKRACIA ATËHERË DHE SOT

DIAMANT (9), ELEJSA (9), VIOLA (9), MELISA (9), MERITON (9), KORAB (9), ARMIRA (9)

Mësoni për demokracinë në artikullin tonë

Ne në demokraci kemi shumë të drejta, sepse demokracia është udhëheqje e popullit. Disa nga të drejtat janë: të votojmë, të shkollohemi, të shprehemi lirshëm, të luajmë, të ushqehemi, të strehohemi, etj. Po ashtu, ne në demokraci jemi të barabartë, pa dallime feje, ngjyre, race dhe kombësie. Demokracia lindi në Athinë, në vitin 507 p.e.s., kur demokracia ishte më ndryshe sesa sot. Atë kohë, të drejta kishin vetëm burrat e pasur, ndërsa të varfërit dhe gratë nuk kishin të drejtë të merrnin pjesë në vendimmarrje. Në Kosovë është shumë e mirë demokracia, por ne duhet të mësojmë shumë që demokracia në të ardhmen të jetë edhe më e mirë.




Gazetarët "Qershia.."



Unë jam vajzë dhe jam e barabartë me djemtë



Feja nuk na pengon të jemi shoqe



Përmes protestës shprehim pakënaqësitë tona



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë:
Tel: +381 38 704 560
E-mail: info@demos-ti.org
Website: www.demos-ti.org

Pjesëmarrësit:
SHFMU „MODEL“
Klasa: IV-1
Vendi: